Një pushkë, një scorpion, pistoleta e karikatorë – arrestohen dy persona në Prishtinë, u gjendet një 'mal' armatim

24/11/2023 09:24

Dy persona janë arrestuar dje në Prishtinë, për shkak të kryerjes së veprës penale 'armëmbajtje pa leje'.

Të njëjtëve gjatë kontrollit në shtëpinë e tyre u janë gjetur: Një armë Scorpion, një pushkë gjuetie, dy revole, fishekë e gjësende të tjera.

"Janë arrestuar dy të dyshuar meshkuj kosovar pasi që gjatë kontrollit në shtëpinë e tyre janë gjetur dhe konfiskuar: një pushkë gjuetie, 57 copa fishekë të pushkës së gjuetisë, një këllëf i pushkës së gjuetisë, një Scorpion, Mod 92 Fs në formë të shkrebzës, dy revole, 43 copa fishekë, 26 copa fishekë me gaz, tre karikatorë të ndryshëm, 3 spreja, 2 spreja për pastrimin e armëve, 1 këllëf i pistoletës, 3 thika me këllëf dhe 1 brisk të vogël. Pas intervistimit me vendim të prokurorit të dyshuarit janë dërguar në mbajtje", thuhet në njoftimin e PK-së.

LAJME TË FUNDIT

U prezantua rrejshëm si inspektor policor, intervistohet në polici kaçanikasi

Golashënuesi më i mirë në La Liga 2,...

Arratiset i burgosuri nga burgu i Lipjanit, shtetas i Malit të Zi


Mike Tyson i jep zemër boksierit shqiptar pas meçit, bën me duar shqiponjën

Artikuj të ngjashëm

November 24, 2023
U prezantua rrejshëm si inspektor policor, intervistohet në polici kaçanikasi

November 24, 2023
Arratiset i burgosuri nga burgu i Lipjanit, shtetas i Malit të Zi

November 24, 2023
Gërvalla i del në krah Gani Jakupit: Paguhet për një projekt,...


November 24, 2023
Zhduket një person në Podujevë

November 24, 2023
Katër kandidatë synojnë pozitën e kryeprokurorit të Speciales, intervistimi mbahet sot...

November 24, 2023
Parashikimi i motit për sot

©Copyright lajmi.net 2022. All Rights Reserved Privacy Policy